

**Fjala JULIEN ROCHE**  
Assemblée Générale  
**CCI France-Albanie**

---

**Mirëmbërëma të gjithëve dhe mirëserdhët në mbrëmjen e Asambleje të Përgjithshme të CCI tonë**

Në mënyre të veçantë dua të falenderoj të gjithë anëtarët që morën pjesë sot në zgjedhje, qofshin ata që votuan për herë të parë ose që votojnë që prej 5 vitesh. Sot jemi një organizatë e fortë prej 71 anëtarësh të cilët janë të vendosur në Shqipëri dhe në Francë.

Përgëzoj personalisht anëtarët e këshillit drejtues që u zgjodhën sonte gjatë mbledhjes së Asamblesë (Elisabeth Gjoni-Zv. Kryetare e Pare, Teit Gjini, Zgjim Mita, Ylla Sula, Gasmen Toska, Jean Alain Jouan, Eni Kalo, Bora Feri, Aleksander Xhuvani)

Falenderoj në veçanti 22 kompani të cilët janë anëtare që prej 2012

**Green Technologies**  
**Société Générale Albania**  
**Boga & Associates**  
**Aleat- Safran Group**  
**Amadeus Group**  
**Kastrati Group**  
**Eagle Security**  
**Marlotex**  
**Aleksander Xhuvani**  
**Edvin Murati**  
**M-pay**  
**Pedersen & Partners**  
**Albinfos**  
**Kalo & Associates**  
**Celesi Group**  
**Selenice Bitumi**  
**Century21 Mei Properties**  
**Tashko Pustina**  
**Maktirana Hotel (Hotel Sheraton)**  
**Avel -Peugeot**  
**Diamant**  
**Nexter Systems**

Përfitoj nga rasti për të falenderuar miqtë tanë të cilët mbështetën këtë mbrëmje.  
**Maktirana Hotel, Albesol, Société Générale Albania, Vila Alejandro**

Falë bujarisë suaj, kjo mbrëmje u organizua në mënyrë të shkëlqyer. Falenderojmë Hotelin Maktirana dhe drejtorin e saj të shitjeve të marketingut Bujana Xhaxhiu për mikpritjen në hotelin e tyre.

2017 ishte një vit pasionant për Dhomën tonë:

Asambleja e Përgjithshme në fillim të vitit që lam pas, u ndoq nga aktivitetet e përvitshme si ; Pranvera e Frankofonisë, Forumi i Grave Frankofone, Forumi Ekonomik me studentët, Festa e Verës, Dita Ndërkombëtare e Diabetit në bashkëpunim me Sanofin, Business Cocktail në bashkëpunim me Shoqatën Farmaceutike në Shqipëri.

Forumit Ekonomik me studentët këtë vit u organizua në bashkëpunim me Ambasadën e Francës. Së fundmi, koktejl « Wine Tasting » i organizuar në bashkëpunim me 11 Dhoma të huaja të cilat mbledhën më shumë se 150 pjesëmarrës, u përcoll si event i më i suksesshëm i vitit, duke mbyllur më së miri vitin 2017.

**Projektet e mëdha për vitin 2018 :** “Printemps de la Francophonie”, Mars 2018, me tre evente :

- Darka « Gout de France »
- Forum économique
- Forum des femmes francophones

Do të marrim pjesë në organizimin e dy Forumeve ekonomike që do të organizohen nga B France në prill dhe maj 2018. “Festa e verës”, qershor 2018 "Wine tasting event", qershor 2018, Tourism Fair, shtator ose tetor 2018, Beaujolais Nouveau, nëntor 2018; Event për anëtarët me qëllimin për të promovuar kompanitë anëtare, etj

**Unë do të propozoj gjatë këtij mandati krijimin e komisioneve në sektorë të ndryshëm : energji, turizem, ligjore , tekstil etj... ..këto komisione do të drejtohen nga një Kryetar i cili do të marrë iniciativë për t’ju ndihmuar.**

Faleminderit të gjithëve që ishit të pranishëm sonte dhe ju uroj një mbrëmje të bukur! CCI France Albanie dhe une, jemi në dispozicionin tuaj!

**Julien Roche  
Kryetar**